

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6183  
E shtunë, 5 dhjetor 2020  
çmimi 0.40

## Mungesa e oksigjenit vë në sprovë spitalet rajonale



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË PREMTEN SEANCË PLENARE



## MË NË FUND KUVENDI VOTON PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premtën Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me 72 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Miratimi i Projektligjit për Rimëkëmbje

Ekonomike erdhi pas pajtimit të qeverisë Hoti me kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) lidhur me këtë projektligj. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk është

përkrahur nga partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje. Deputeti i këtij subjekti politik, Hekuran Murati, ka thënë se ky projektligj ka shumë pabarazi

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAFER GASHI

## PARTITË TË DALIN ME QËNDRIM TË PËRBASHKËT PËR PRESIDENTIN



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Xhafer Gashi, ka thënë se subjektet politike duhet të dalin me një qëndrim të përbashkët për pozitën e presidentit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se situata nëpër të cilën po kalon Kosova kërkon bashkim të spektrit politik. Megjithatë, ai ka

vlerësuar se ky post do të duhet t'i takonte AAK-së. Sipas Gashit, lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, është person bashkues dhe duhet t'i prijë vendit. "Z. Ramush Haradinaj është njeri i unitetit. Ai edhe në kohët më të vështira për vendin, por edhe në kohën e paqes ka dhënë kontribut të çmuar për Kosovën", ka thënë Gashi

### AKTUALE



"PFIZER" DO TË PRODHJË  
PËRGJYMË MË PAK VAKSINA  
KËTË VIT

REPUBLIKA E KOSOVËS  
RENDITET SI NJË NDËR VENDET  
MË TË SIGURTA NË BOTË

EDHE 11 TË VDEKUR DHE 478  
RASTE TË REJA ME COVID NË  
KOSOVË

KOSOVA DHE SHQIPËRIA,  
FAKTORË STABILITETI NË RAJON

### EKONOMI



GUVERNATORI I BQK-së:  
SEKTORI BANKAR I KOSOVËS  
ËSHTË ZHVILLUAR ME NJË  
RITËM TË SHPEJTË

AUTORITETI I KONKURENCËS  
HETON KEDS-in DHE KESCO-n,  
KËRKOHET PËRFSHIRJA E  
PROKURORISË SPECIALE

### KULTURË

DOLI NGA SHTYPI LIBRI  
"BESIMI ISLAM, SHTYLLAT  
DHE VEÇORITË" I MYFTIUT  
NAIM EF. TËRNAVA

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOV.  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## “Pfizer” do të prodhojë përgjysmë më pak vakcina këtë vit

LONDËR, 4 DHJETOR - Problemet në zinxhirin e furnizimit me lëndën e parë për prodhimin e vaksinave kundër Covid-19 e kanë detyruar kompaninë “Pfizer” që ta ulë objektivin e saj të prodhimit për këtë vit. Kështu ka njoftuar një zëdhënës e “Pfizer” për “Reuters”. “Pfizer” ka njoftuar në javët e fundit se parashikon prodhimin e 50 milionë dozave të vaksinës Covid-19 këtë vit. Kjo shifër është përgjysmë më e ulët se ajo që ishte paraparë më herët prej 100 milionë

dozash.

Vaksina e “Pfizer & BioNtech” është paraparë të injektohet me dy doza, që do të thotë se 50 milionë doza janë të mjaftueshme për t'i vaksinuar 25 milionë njerëz.

Zëdhënësja përmendi vonesat në rezultatet nga prova klinike të “Pfizer”, si një arsye për numrin më të vogël të dozave, që pritet të prodhohen deri në fund të vitit 2020.

“Wall Street Journal” ishte i pari që raportoi lajmin. Gazeta raportoi se një person i pidentifikuar, i përfshirë

drejtpërdrejt në zhvillimin e vaksinës të “Pfizer”, tha se “disa sasi të lëndëve të para nuk arritën t'i përmbushin standardet”, gjë që shkaktoi vonesa të prodhimit.

“Pfizer” aplikoi në nëntor për autorizimin emergjent për vaksinën e saj kundër Covid-19 nga rregullatorët e ShBA-së. Zyrtarët amerikanë thanë se ata presin që vakcina e saj ta marrë miratimin këtë muaj. Rregullatorët në Mbretërinë e Bashkuar kanë autorizuar tashmë vaksinën e “Pfizer”-it për përdorim në atë vend.



## Portugalia: Bllokimi i fondeve të BE-së është i papranueshëm



LISBONË, 4 DHJETOR - Portugalia u është bashkuar shteteve të Bashkimit Evropian për t'i dënuar Poloninë dhe Hungarinë për pengim të miratimit të paketës së bllokut evropian për rimëkëmbje nga koronavirusi. Këto dy shtete janë duke bllokuar këtë proces pas kushtëzimeve që u janë vënë nga blloku evropian për çështjet rreth sundimit të ligjit, transmeton agjencia e lajmeve

“Reuters”. “Është e papranueshme që dy shtete anëtare të mund të bllokojnë një vend që është shumë i rëndësishëm dhe vendimtar për gjithë Bashkimin Evropian dhe për rimëkëmbjen e Evropës dhe për një argument të tillë”, ka thënë ministri i Jashtëm portugez, Augusto Santos Silva, në një konferencë online në Romë. “Sundimi i ligjit është një vlerat dhe

parimet bazike në Bashkimin Evropian”, ka thënë ai. Hungaria dhe Polonia kanë bllokuar për disa javë lëshimin e fondeve në vlerë të 1.85 trilion eurosh nga buxheti shtatëvjeçar i BE-së dhe fondi për zhvillim post-Covid. Ato kundërshtojnë përpjekjet e bllokut evropian që të ndajë fonde për këto shtete, pasi ta respektojnë sundimin e ligjit dhe normat demokratike.

## “Facebook”-u do të fshijë lajmet e rreme për vaksinën kundër Covid-19

NJU JORK, 4 DHJETOR - “Facebook” ka njoftuar se do t'i heqë postimet që përmbajnë pretendime të rreme për vaksinën kundër Covid-19. Këto masa merren në kuadër të përpjekjeve të kësaj kompanie për ta luftuar dezinformimin në platformën e saj. Gjiganti i mediave sociale rregullisht heq informacione të pasakta dhe potencialisht të dëmshme në lidhje me virusin dhe që nga tetori ka ndaluar reklamën që dekurajojnë njerëzit ta marrin vaksinën përmes së cilës synohet t'i jepet fund



pandemisë. “Kjo mund të përfshijë pretendime të rreme në lidhje me sigurinë, efikasitetin, përbërësit ose efektet anësore të vaksinave, duke përfshirë pretendimet e rreme se vaksinat Covid-19 përmbajnë mikroçipa, ose

ndonjë gjë tjetër që nuk është në listën zyrtare të përbërësve të vaksinave, si dhe teori konspirative që janë dëshmuar si të rreme”, ka njoftuar “Facebook”.

Derisa pandemia e koronavirusit po shtohet në

pjesën më të madhe të botës, vendet po përpiqen të sigurojnë furnizime të mundshme të vaksinave dhe po përgatitin plane për veprimet e para që do të ndërmarrin në javët e ardhshme. Shpresat janë të mëdha se vaksinat mund të jenë gati për përdorim para fundit të vitit, me dy vakcina kryesore nga

“Moderna” dhe “BioNTech/Pfizer”, që tashmë kanë kërkuar miratimin për përdorim emergjent në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë. Britania e Madhe ka miratuar vaksinën e kompanisë “Pfizer” dhe “BioNTech” dhe brenda ditësh do ta fillojë procesin e vaksinimit të popullatës.

## BE-ja kërcënon Turqinë me sanksione

BRUKSEL, 4 DHJETOR - Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë se Turqia nuk e ka zbutur qëndrimin ndaj Greqisë dhe paralajmëroi se Bashkimi Evropian tani do të konsiderojë vendosjen e sanksioneve. “Unë mendoj se loja e macës dhe miut duhet të mbarojë”, ka deklaruar



Michel, duke iu referuar aktiviteteve të përsëritura të Turqisë në ujërat greke. “Ne do të kemi një debat në samitin e

Bashkimit Evropian më 10 dhjetor dhe ne jemi të gatshëm t'i përdorim mjetet që kemi në dispozicionin tonë”, ka thënë ai. Në periudhën e fundit Turqia ka sfiduar Greqinë në Mesdheun Lindor, duke dërguar vazhdimisht një anije kërkimi të gazit në ujërat greke.

## Ndërron jetë ish-deputeti socialist Marko Bello

TIRANË, 4 DHJETOR - Ish-deputeti i Partisë Socialiste, Marko Bello, është ndarë nga jeta në moshën 59-vjeçare. Pas një qëndrimi disajavor në Turqi, Marko Bello e humbi betejën me Covid-19. Në periudhën 1997-2000, Marko Bello ka shërbyer si ambasador i Shqipërisë në Rumani dhe më pas zëvendësministër i Mbrojtjes.

Marko Bello ka qenë deputet i PS-së për tri mandate në vitet



2001-2013. Gjithashtu, ai ka mbajtur edhe postin e ministrit për Integrimin Evropian dhe ministër Shteti për Koordinimin Qeveritar.

Flet për “Epokën e re”, Xhafer Gashi

# Partitë duhet të dalin me qëndrim të përbashkët për presidentin



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Xhafer Gashi, ka thënë se subjektet politike duhet të dalin me një qëndrim të përbashkët për pozitën e presidentit. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se situata nëpër të cilën po kalon Kosova kërkon një bashkim të spektrit politik. Megjithatë, ai ka vlerësuar se ky post do të duhej t’i takonte AAK-së. Sipas Gashit, lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, është person bashkues dhe duhet t’i prijë vendit. “Z. Ramush Haradinaj është njeri i unitetit. Ai edhe në kohët më të vështira për vendin, por edhe në kohën e paqes ka dhënë kontribut të çmuar për Kosovën”, ka thënë Gashi

çështje Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka organet brenda partisë, si kryesia e nivelit qendror dhe këshilli drejtues, përmes të cilave del me qëndrimet e veta, andaj edhe për këtë çështje, në rast se duhet të diskutohet, besoj se AAK-ja do të dalë me qëndrimet e veta”, ka vlerësuar Gashi.

Kryetari i Obiliqit ka folur edhe për gjendjen pandemike në vend dhe komunën që ai drejton. Sipas tij, pandemia Covid-19 është e menaxhueshme në komunën e tij. “Në Obiliq, përkundër rritjes së numrit të rasteve të të infektuarave, ashtu si në tërë vendin, situata është e menaxhueshme. Të gjithë mekanizmat anti-Covid në Komunën e Obiliqit janë nën funksion dhe bazuar në raportimet e tyre, situata është nën kontroll. Aktualisht në Obiliq kemi 133 raste aktive dhe 424 raste të shëruar”, ka thënë Gashi.

**“Epoka e re”:** Z. Gashi, cila është gjendja me Covid-19 në Komunën e Obiliqit?

**Gashi:** Në Obiliq, përkundër rritjes së numrit të rasteve të të infektuarave, ashtu si në tërë vendin, situata është e menaxhueshme. Të gjithë mekanizmat anti-Covid në Komunën e Obiliqit janë nën funksion dhe, bazuar në raportimet e tyre, situata është nën kontroll. Aktualisht në Obiliq kemi 133 raste aktive dhe 424 raste të shëruar.

**“Epoka e re”:** Sa jeni i kenaqur

me mbështetjen e qeverisë?

**Gashi:** Komuna e Obiliqit në vazhdimësi ka koordinuar veprimet për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 me të gjitha institucionet e nivelit qendror, edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e programit të rimëkëmbjes ekonomike, komuna e Obiliqit ka përfutur mjete prej 290 530 18 eurosh të cilat i kemi ndarë nëpër sektorët më të prekur nga pandemia Covid-19. Për sektorin e shëndetësisë kemi ndarë 90 000 00 euro, të bujqësisë 70 000 00 euro dhe 130 000 00 euro për bizneset dhe gastronomitë që ta vazhdojnë punën pas dëmeve të shkaktuara nga kjo pandemi. Duke pasur parasysh faktin se kjo pandemi ka shkaktuar dëme në të gjitha sferat, uroj që qeveria të vazhdojë të ofrojë gatishmëri në përkrahjen e kërkesave të institucioneve të nivelit lokal, të cilat janë konfrom kërkesave të qytetarëve, në mënyrë që të kemi një rimëkëmbje më të fuqishme ekonomike dhe sociale.

**“Epoka e re”:** Kryeministri ka paralajmëruar mbajtjen e një tryeze me partitë politike për të diskutuar për ceshtjen e presidentit. Prisni që në këtë tryeze partitë politike do të pajtohen për këtë ceshtje?

**Gashi:** Situata nëpër të cilën po kalon vendi ynë kërkon unitet politik mes partive, prandaj unë shpresoj se partitë politike duhet

të dalin me një qëndrim të përbashkët lidhur me këtë çështje.

**“Epoka e re”:** AAK-ja ka dalë me z. Haradinaj si kandidat për president. Nese partitë e tjera nuk e perkrahin këtë kandidaturë, si do te veproje AAK-ja?

**Gashi:** Edhe në deklarimet e mia të mëhershme kam theksuar se, sipas të gjitha formulave politike dhe koalicioneve, presidenti duhet t’i takojë Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidatit të saj për president, z. Ramush Haradinaj. Duke pasur parasysh periudhën nëpër të cilën po kalon Kosova, jam shumë i bindur se kandidati i AAK-së për president, në këtë rast z. Ramush Haradinaj, është një njeri i unitetit i cili edhe në kohët më të vështira për vendin, por edhe në kohën e paqes ka dhënë kontribut të çmuar për Kosovën.

**“Epoka e re”:** Së fundi edhe përfaqësues të PDK-së kanë thënë se synojnë ta marrin këtë pozitë. A është e gatshme AAK-ja ta bejë ndonjë kompromis me PDK-ne për pozitën e presidentit?

**Gashi:** Për këtë çështje Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka organet brenda partisë, si kryesia e nivelit qendror dhe këshilli drejtues, përmes të cilave del me qëndrimet e veta, andaj edhe për këtë çështje, në rast se duhet të diskutohet, besoj se AAK-ja do të dalë me qëndrimet e veta.

**EPOKA ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Xhafer Gashi, e ka mirëpritur paralajmërimin për një tryezë të partive politike, në të cilën do të diskutohet çështja e presidentit. Ai ka thënë se situata nëpër të cilën po kalon Kosova kërkon bashkim të spektrit politik. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Gashi ka thënë se partitë politike duhet të dalin me një qëndrim të përbashkët lidhur me këtë çështje. “Situata nëpër të cilën po kalon vendi ynë kërkon një unitet politik mes të gjitha partive, prandaj shpresoj se partitë politike duhet të dalin me një qëndrim të përbashkët lidhur me këtë çështje”, ka deklaruar Gashi. Megjithatë, ai ka këmbëngulur se ky post duhet t’i takojë AAK-së. Sipas tij, në proceset nëpër të

cilat po kalon Kosova, lideri i AAK-së është kandidati i duhur që duhet të jetë në pozitën e shefit të shtetit. “Edhe në deklarimet e mia të mëhershme kam theksuar se, sipas të gjitha formulave politike dhe koalicioneve, presidenti duhet t’i takojë Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidatit të saj për president, z. Ramush Haradinaj. Duke pasur parasysh periudhën nëpër të cilën po kalon Kosova, jam shumë i bindur se kandidati i AAK-së për president, këtë rast z. Ramush Haradinaj, është një njeri i unitetit i cili edhe në kohët më të vështira për vendin, por edhe në kohën e paqes ka dhënë kontribut të çmuar për vendin”, është shprehur ai.

I pyetur nëse është i mundshëm një kompromis në mes të PDK-së dhe AAK-së për këtë çështje, ai ka thënë se për gjithçka vendosin organet e partisë. “Për këtë



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË PREMTEN SEANCË PLENARE

# MË NË FUND KUVENDI VOTON PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premtën Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me 72 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Miratimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike erdhi pas pajtimit të qeverisë Hoti me kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) lidhur me këtë projektligj. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk është përkrahur nga partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje. Deputeti i këtij subjekti politik, Hekuran Murati, ka thënë se ky projektligj ka shumë pabarazi

Ai ka falënderuar deputetët e Kuvendit për votimin e këtij projektligji. “U jam mirënjohës dhe u falënderohem të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët besuan dhe e mbështetën Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike të Qeverisë së Kosovës. Nga ky projektligj qytetarët dhe bizneset do ta ndiejnë përkrahjen direkte të qeverisë, që bashkërisht t’i kalojmë sa më lehtë pasojat e shkaktoara nga Covid-19”, ka thënë Hoti. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk është përkrahur nga partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje. Deputetët të kësaj partie kanë kritikuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike pasi që, sipas tyre, nuk do të sjellë

rimëkëmbje ekonomike në vend. “Nëse duam të shohim se çfarë rimëkëmbje ekonomike mund të bëjnë këta (LDK-ja dhe PDK-ja), mjafton t’u lëshohet një sy ndërmarrjeve publike. Shikoni në çfarë gjendje i kanë sjellë dhe pastaj mendoni se a me të vërtetë do ta rimëkëmbin ekonominë. Këto ndërmarrje, duke filluar nga Telekomit e Trepça, po përfundojnë me llogari bankare të bllokuara, se nuk kanë para as pagat t’i paguajnë”, ka thënë Hekuran Murati, deputet i Lëvizjes Vetëvendosjes. Shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, fillimisht ka shprehur keqardhje për vonesën nga qeveria që nuk ka arritur ta adresojë këtë çështje

mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021, përjashtimisht disa dispozitave që do të jenë të vlefshme deri në vitin 2028. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ky projektligj pasi të hyjë në fuqi krijon një momentum të ri në Kosovë. “Jemi plotësisht të përgatitur që ta fillojmë zbatimin e këtij ligji menjëherë pasi që janë bërë përgatitjet

nëpër ministri përkatëse, në Trustin e Kursimeve Pensionale, në mënyrë që para vitit të ri pjesa më e madhe e këtyre fondeve të futen në ekonomi dhe buxhetin e familjes, me shpresë që në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm të shpërndajmë këtë pjesë dhe të kthehemi në normalitet në mesin e vitit të ardhshëm”, ka thënë Hoti.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Me 72 vota për dhe asnjë kundër Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premtën në lexim të dytë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19. Ky projektligj, i cili shndërrohet në ligj pas dekretimit të presidentit të Kosovës, do të



jetike për qytetarët e Kosovës dhe ekonominë e vendit. "Ligji që sot e kemi nuk është ligj për votuesit e një subjekti apo tjetrit politik. Është ligj për të gjithë qytetarët dhe bizneset e Kosovës. Nga ky ligj përfitojnë bizneset, numri i të cilave mund të jetë mbi 50 mijë biznese. Si rezultat i granteve, nga kjo përfitojnë dhjetëra të punësuar në sektorin privat që i kanë humbur vendet e punës për shkak të pandemisë", ka thënë Hamza.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka thënë se me këtë projektligj rreth 600 milionë euro do të kalojnë te qytetarët e Kosovës.

"I kemi dhënë përkrahje këtij projektligji. Është e vërtetë se kemi pasur pengesa nga Lista Serbe, por LDK, PDK, Nisma po e dëshmojnë që kur është në interes për qytetarët të kalojë një ligj që është i rëndësishëm", ka deklaruar Haradinaj.

Përkrahje këtij projektligji në lexim të dytë i ka dhënë edhe grupi parlamentar Nisma-AKR-6+.

Qëllimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është plotësimi dhe ndryshimi i disa ligjeve, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Ky projektligj ka paraparë që kontributpaguesit të mund t'i

tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sipas projektligjit, deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së 10 përqindëshit nga kontributpaguesi, Qeveria e Kosovës ta kompensojë atë brenda pesë vjetëve të ardhshme.

Projektligji parasheh themelimin e një fondi i veçantë i cili do të shërbejë për t'i paguar të gjithë të punësuarit në sektorin privat që kanë humbur vendet e tyre të punës si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Sipas këtij projektligji, të gjithë punëtorët e sektorit privat të regjistruar si të papunë, e që kanë qenë në marrëdhënie pune deri në shtator 2020, por që nga muaji tetor 2020 janë liruar nga punëdhënësi si pasojë e ndikimit të Covid-19, të paguhen nga qeveria së paku tre deri në katër muaj përkatës. Po në bazë të projektligjit do të themelohet granti në shumën prej 200 milionë eurosh për ndihmë direkte financiare bizneseve, të cilat kanë vështirësi funksionimi si rezultat i ndikimit të Covid-19. Qeveria e Kosovës do ta lirojë nga TVSh-ja lëndën e parë e cila prodhohet nga bizneset e Kosovës, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo.

Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike ka paraparë që Fondi Kreditor Garantues i Kosovës (FKGK) të autorizohet që të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës nga 50 deri në 80 për qind. Po ashtu, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, Ministria e Financave mund ta shtyjë afatin e pagesës së tatimeve deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kriteret për shtyrjen e afateve përcaktohen nga Ministria e Financave në Qeverinë e Kosovës.

Pas miratimit të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike në Kuvend, shefi i Grupit Parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka thënë se nuk ka qenë punë e lehtë miratimi i këtij projektligji.

Për votimin e këtij projektligji Hamza ka falënderuar të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Ai ka thënë se qeveria Hoti është e dobët dhe këtë po e tregon edhe në bazë të numrave që i ka në Kuvend. "Po them se kjo është qeveri e dobët dhe këtë po e tregon edhe fuqia politike në Kuvend, sepse nuk i kanë as numrat për shumicën e thjeshtë. Kemi qenë konstruktivë nga fillimi, e kemi votuar rishikimin e buxhetit, sot votuam dhe kontribuam në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Përveç që kemi kritikuar, kemi ofruar alternativa dhe i kemi inkorporuar në legjislacion", ka deklaruar Hamza.

Lëvizja Vetëvendosje ka kritikuar ashpër qeverinë Hoti pas votimit të Projektligjit për

Rimëkëmbjen Ekonomike. Deputeti i LV-së, Hekuran Murati, në një konferencë për media ka thënë se ky projektligj ka shumë pabarazi. "E pamë se u dëshmuaj ajo që kemi thënë që nga fillimi, se qëllimi i kësaj qeverie është që me paratë që janë në buxhet të mos u ndihmojnë qytetarëve, por me ato para që janë në buxhet ka tendencë t'u ndihmojë oligarkëve e bizneseve të afërta me ta", ka thënë deputeti Hekuran Murati. Ai ka pohuar se ky projektligj ka shumë defekte. "Ky projektligj s'mund të quhet i rimëkëmbjes. Është me shumë defekte, ka shumë pabarazi. Mund të quhet si një ligj që merr paratë nga taksapaguesit e varfër dhe i orienton drejt të pasurve e qytetarëve të tjerë u thuhet merrni paratë tuaja nga Trusti", ka thënë Murati.

## Trusti njofton për mënyrën e aplikimit për tërheqje të kursimeve

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka bërë me dije të premtën mënyrën e aplikimit për tërheqje të 10 për qind të kontributeve personale, pas miratimit të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike në Kuvendin e Kosovës. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ky institucion ka thënë se procesi i aplikimit për tërheqje të këtyre mjeteve do të bëhet pas publikimit të ligjit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. "Menjëherë pasi ligji të hyjë në fuqi, Trusti do ta bëjë të ditur uebfaqen ku do të mund të aplikohet për 10-përqindëshin si dhe do t'i japim detajet për aplikim: 1)

Aplikimi për tërheqjen e 10-përqindëshit do të bëhet vetëm përmes internetit (do të jetë një uebfaqe e veçantë, që do ta bëjmë publike sapo të hyjë ligji në fuqi) dhe jo fizikisht në zyrën e Trustit; 2) Aplikimi për tërheqje mund të bëhet nga çdo kontribuues që ka mjete në Trust; 3) Aplikimi mund të bëhet vetëm me llogari bankare aktive personale në Kosovë (jo me llogari bankare të familjarit apo kujtdo tjetër); 4) Aplikimi me llogari bankare jashtë Kosovës nuk mund të bëhet; 5) Aplikimi me llogari bankare të biznesit nuk mund të bëhet", ka njoftuar Trusti.

## Republika e Kosovës, një ndër vendet më të sigurta në botë

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Republika e Kosovës në Indeksin Global të Terrorizmit është renditur në vendin e 135 si ndër vendet më të sigurta në botë ku ndikimi i terrorizmit është minimal. Kjo statistikë është bërë publike në edicionin e tetë të Indeksit Global të Terrorizmit (GTI) të Institutit për Ekonomi dhe Paqe.


Raporti i Indeksit Global të Terrorizmit është hartuar

duke përdorur të dhëna nga baza e të dhënave globale të terrorizmit (GTD) dhe burime të tjera.

Ky raport ofron një përmbledhje të tendencave dhe të modeleve kryesore globale në terrorizëm gjatë 50 vjetëve të fundit, duke vendosur një theks të veçantë te tendencat gjatë dekadës së kaluar.

Të dhënat janë mbledhur dhe përpiluar nga Konsorciumi

Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (START) në Universitetin e Maryland ne ShBA. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka theksuar se vazhdon të mbetet e përkushtuar për luftimin e të gjitha formave të ekstremizmit dhe terrorizmit si dhe të jetë partnere e barabartë në koalicionin global në luftën kundër terrorizmit.



# Mungesa e oksigjenit vë në sprovë spitalet rajonale

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Spitali i Mitrovicës së Jugut këtë javë është ballafaquar me mungesë të oksigjenit dhe për këtë arsye ka huazuar disa bombola oksigjeni nga Spitali i Vushtrrisë në mënyrë që pacientët të mos pësojnë.

Vështirësi për furnizim me oksigjen ka edhe Spitali i Gjilanit. Spitalit të Pejës i është dashur të bëjë një plan B në rast të vonësës së furnizimit, kurse ai i Prizrenit ka vendosur të përdorë oksigjen të lëngshëm.

Pandemia me Covid-19 ka rritur nevojën për furnizim me oksigjen në të gjitha institucionet publike shëndetësore, ku po trajtohen pacientët e infektuar me koronavirus, e të cilët kanë probleme me frymëmarrje.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK-ja pranojnë se ka vështirësi furnizimi me oksigjen, por shtojnë se asnjë pacient nuk ka vuajtur për mungesë të oksigjenit.

Drejtori i Spitalit në Mitrovicën e Jugut, Sadik Fejza, i tha "Radios Evropa e Lirë" se ditët e fundit, për shkak të shtimit të numrit të pacientëve të hospitalizuar, është

rritur edhe kërkesa për oksigjen. "Para dy ditësh kemi qenë në krizë dhe na është rrezikuar gjendja për shkak se kemi pasur pacientë të shumtë. Ato dy tri-ditë kemi huazuar nga Spitali i Vushtrrisë pesë boca, derisa ka ardhur kontingjenti të nesërmen. Dje ka ardhur edhe një sasi e kënaqshme. Janë 30 pacientë të shtrirë aktualisht, derisa kapacitetet janë deri 50 shtretër", ka thënë Fejza.

Furnizimi me oksigjen edhe në Spitalin e Gjilanit po bëhet në baza ditore. Kështu tha Nisret Hajrullahi, drejtor i këtij spitali. Sipas tij, sfidë, pos të tjerash, mbetet edhe sigurimi i oksigjenit në këtë spital. "Kemi vështirësi në furnizim pasi, po të kemi mungesë, do të ndodhte katastrofë. Janë rritur kërkesat, është rritur numri i pacientëve që po kanë nevojë për oksigjen. Ne i kemi 57 pacientë në spitalin tonë. Rezervë të oksigjenit nuk kemi, furnizimi bëhet në baza ditore. Përmes operatorit ekonomik furnizohemi çdo ditë. Kemi kërkuar që të na përkrahin në sasi më të madhe me oksigjen", ka

thënë ai.

Në këtë spital janë 130 shtretër të ndarë për pacientët me Covid-19, ku aktualisht janë 97 pacientë të hospitalizuar. Në gjendje të rëndë janë 26 prej tyre.

Edhe në Spitalin e Pejës sfida më e madhe është furnizimi me oksigjen.

Zëdhënësi i spitalit, Naim Sahiti, tha se kanë bërë një plan B në rast të vonësës së oksigjenit. "Kjo është një problematikë që po shfaqet gjithkund në rajon, e sidomos te ne po shfaqet më shumë. Por, deri tash me përkrahjen e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës nuk kemi mbetur asnjëherë pa të. Disa lëvizje i kemi bërë edhe ne, pasi kemi furnizuar me oksigjen koncentrator, pajisje të cilat i kemi si variant të dytë. Pra, deri tash nuk kemi mbetur pa oksigjen, por ajo që qëndron është një furnizim tepër i vështirësuar dhe është sfidë e veçantë për ne si spital", ka deklaruar Sahiti.

Për dallim nga spitalet rajonale që përdorin boca oksigjeni të gaztë, Spitali i Prizrenit ka zgjedhur të

përdorë për pacientët me Covid-19 oksigjen të lëngshëm. Sipas drejtorit, Afrim Avdaj, ky spital është i vetmi që ka rezervë oksigjeni prej 10 tonësh. "Furnizimi me oksigjen aktualisht është i mirë, pasi ne kemi spitali i vetëm që furnizohemi me oksigjen të lëngshëm dhe kemi 10 tonë. Aktualisht në Spitalin e Prizrenit i kemi 179 pacientë të hospitalizuar. Me Covid-19 janë 111, ku prej tyre një është në respirator, një në mjekim intensiv, e 124 me oksigjeno-terapi. Gjithsej janë 253 shtretër të ndarë për pacientë me Covid-19 në këtë spital", është shprehur ai.

Oksigjen të lëngshëm përdorin spitalet që e kanë të instaluar brenda mureve sistemin e oksigjenimit. Ndërkaq, atë të gaztë e përdorin përmes bombolave, varësisht ku ka nevojë. Jo të gjitha institucionet shëndetësore e kanë sistemin për furnizim me oksigjen të lëngët. Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Armend Zemaj, ka thënë këtë javë, gjatë një ngjarjeje, se ShSKUK-ja dhe Ministria e Shëndetësisë "po e

bëjnë të pamundurën që të ketë furnizim të mjaftueshëm dhe mos të mbetet (jashtë) asnjë pacient për ndonjë shërbim që është i domosdoshëm".

"Furnizimet janë të rregullta, me vështirësi por, si do që të jetë, pacientët janë duke i marrë këto shërbime", ka thënë Zemaj.

Ndërkaq për furnizime me barna, oksigjen e material mjekësor shpenzues përgjegjës është Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK). Ushtruesi i detyrës i drejtorit në këtë institucion, Valbon Krasniqi, tha në të njëjtën ngjarjeje se deri tani asnjë pacient nuk ka vuajtur për mungesë të oksigjenit, ndonëse furnizimi është sfidë.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka kontratë aktive për furnizim me oksigjen me "Medical Group". Kjo njëherësh është e vetmja kompani që furnizon me oksigjen këtë institucion. Ndërkohë, spitalet rajonale bëjnë kërkesë në ShSKUK, varësisht nga nevoja që kanë dhe furnizohen përmes këtij institucioni me oksigjen.



## Shtyhet seanca për rastin e Oliver Ivanoviqit

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Seanca përgatitore në çështjen e vrasjes së udhëheqësit të Nismës Qytetare "Liria, Demokracia, Drejtësia" (SDP), Oliver Ivanoviq, e cila filloi të premten në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është shtyrë për datën 11

dhjetor. Avokati mbrojtës, Dejan Vasiq, i tha "Radios Evropa e Lirë" se seanca është shtyrë për shkak të arsyeve teknike, duke mos dhënë më shumë detaje.

Në nëntor të këtij viti Prokuroria Speciale në Prishtinë ngriti një padi të re

kundër të dyshuarve për ndihmë në vrasjen e politikanit serb nga Kosova, Oliver Ivanoviq. Kjo është aktakuza e tretë e ngritur në këtë rast dhe avokati Dejan Vasiq, i cili po e mbron pjesëtarin e policisë Dragisha Markoviq, pretendon se këto

aktakuza janë pothuajse të njëjta, pra se ka pasur shumë pak korrigjime që nuk janë thelbësore për çështjen. Oliver Ivanoviq u vra më 16 janar 2018, me gjashtë të shtëna në shpinë, përpara lokaleve të partisë së tij në Mitrovicën e Veriut.



## Selmanaj diskuton me ministrat për reformën në zbatimin e MSA-së

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Driton Selmanaj, ka zhvilluar të premten një takim joformal me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, zëvendësministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Nitaj, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, si dhe me përfaqësues

të Ministrisë së Financave dhe të Punëve të Brendshme, me të cilët ka diskutuar rreth reformave që duhen ndërmarrë në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (PKZMSA). Takimi kishte për qëllim informimin rreth metodologjisë së punës në mënyrë që prioritetet e dala nga PKZMSA-ja të përmbushen me kohë dhe të jenë në përputhshmëri me

indikatorët e identifikuar nga ky dokument.

Procesi i integritimit evropian është ndër proceset më të rëndësishme për Republikën e Kosovës dhe, si i tillë, kërkon angazhimin maksimal të të gjitha institucioneve shtetërore. Ndaj takimet e kësaj natyre do të bëhen pjesë përbërëse për përmbushjen e obligimeve sektoriale të dala nga marrëveshja kontraktuale me BE-në.



## Edhe 11 të vdekur dhe 478 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 530 mostra, prej të cilëve kanë rezultuar 478 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar edhe 11 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e personave të vdekur

janë nga komuna: Prishtinë dy raste (77, 65 vjeç), Prizren dy raste (82,72 vjeç), Ferizaj një rast (60 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (70 vjeç), Gjakovë një rast (80 vjeç), Gjilan një rast (72 vjeç), Hani i Elezit një rast (76 vjeç), Klinë një rast (62 vjeç), Suharekë një rast (77 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 41 777 raste nga 149 743 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 073 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 690 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 27 143 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 561. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 205 raste, Mitrovicë 34 raste, Gjilan 29 raste, Podujevë 28 raste, Gjakovë 25 raste, Fushë-Kosovë 23 raste, Suharekë 15 raste, Kamenicë 12 raste, Pejë 12 raste, Ferizaj 11 raste, Lipjan 11 raste, Obiliq 11 raste, Prizren 11 raste, Vushtrri 9 raste, Drenas 7 raste, Viti 7 raste, Skenderaj 6 raste, Deçan 5 raste, Malishevë 5 raste, Klinë 3 raste, Klokot 2 raste dhe me nga 1 rast Dragash, Hani i Elezit, Kaçanik, Ranillug, Shtime.



AMBULANCA PË  
CORONAVIRU

## Reçica i vendosur për njohjen e stazhit të punës së punonjësve të dëbuar me dhunë nga puna nga regjimi serb



PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka takuar të premten Sindikatën e ish-Policëve të Kosovës të viteve '90, në krye me Fatmir Tashollin, për të diskutuar lidhur me njohjen e stazhit të punës së punonjësve të dëbuar me dhunë nga puna nga regjimi

serb i asaj kohe.

Ministri Reçica i njoftoi sindikalistët se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tashmë ka proceduar për miratim në qeveri Projektligjin për plotësimndryshimin e Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe është në diskutime me Zyrën

e Kryeministrit për të shtyrë para këtë projektligj.

Ministri Reçica ka siguruar sindikalistët se është duke bërë përpjekje të mëdha që ky projektligj të miratohet në qeveri këtë vit, me ç'rast do të eliminohej një padrejtësi e madhe që i është bërë kësaj kategorie të shoqërisë me vite të tëra.

## Selmanaj diskuton me ministrat për reformën në zbatimin e MSA-së

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Driton Selmanaj, ka zhvilluar të premten një takim joformal me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, zëvendësministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Nitaj, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, si dhe me përfaqësues

të Ministrisë së Financave dhe të Punëve të Brendshme, me të cilët ka diskutuar rreth reformave që duhen ndërmarrë në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (PKZMSA). Takimi kishte për qëllim informimin rreth metodologjisë së punës në mënyrë që prioritetet e dala nga PKZMSA-ja të përmbushen me kohë dhe të jenë në përputhshmëri me

indikatorët e identifikuar nga ky dokument.

Procesi i integritimit evropian është ndër proceset më të rëndësishme për Republikën e Kosovës dhe, si i tillë, kërkon angazhimin maksimal të të gjitha institucioneve shtetërore. Ndaj takimet e kësaj natyre do të bëhen pjesë përbërëse për përmbushjen e obligimeve sektoriale të dala nga marrëveshja kontraktuale me BE-në.



# Guvernatori i BQK-së: Sektori bankar i Kosovës është zhvilluar me një ritëm të shpejtë

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Bankave, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka vlerësuar lart kontributin e sektorit bankar në mbështetje të zhvillimit ekonomik, sjelljes së inovacionit dhe modernizimit të vazhdueshëm të shërbimeve. Përgjatë viteve, sektori bankar i Republikës së Kosovës është zhvilluar me një ritëm të shpejtë, në hap me standardet bashkëkohore të bankingut duke avancuar në mënyrë të

vazhdueshme shërbimet financiare për ekonominë e vendit, duke ruajtur qëndrueshmërinë financiare si dhe besimin e lartë të publikut. Roli shumë i rëndësishëm i sektorit bankar për ekonominë e vendit u dëshmuua edhe gjatë këtij viti sfidues për shkak të pandemisë, ku sektori bankar pati një rol kyç në lehtësimin e efekteve negative për ekonominë e vendit duke u ofruar lehtësira kredimarrësve në pagesën e kredive si dhe duke siguruar vazhdimësinë e rrjedhës së kredisë drejt


ekonomisë së vendit. Më 19 dhjetor 2019 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën 74/245, e cila përcaktoi 4 dhjetorin si Ditë Ndërkombëtare të Bankave përmes së cilës njihet potenciali i rëndësishëm i bankave në zhvillimin dhe financimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurimin e "know-how" dhe, gjithashtu, në njohjen e rolit jetësor të sistemeve bankare në shtetet anëtare për të kontribuar në përmirësimin e standardit të jetesës.



## Numrin më të madh të vizitorëve dhe të netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Pejës

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Hotelerisë në Kosovë për tremujorin e tretë (TM3) 2020. Në TM3 2020, pjesë e anketës ishin 206 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. Sipas ASK-së, në TM3 2020 numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) ishte 40 272, prej tyre 47.14 përqindësh ishin vendorë dhe 52.86 përqind ishin të jashtëm, ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 80 980, prej tyre 45.32 përqind nga vendorët dhe 54.68 përqind nga të huajt. "Numrin më të madh të vizitorëve dhe të

netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Pejës, me 13 885 vizitorë dhe 38 188 netqëndrime. Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Pejë, Prizren e kështu me radhë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh ishte nga Shqipëria, Gjermania, Turqia etj", është thënë në raportin e ASK-së. Këtij publikimi i është bashkëngjitur edhe një shtojcë e veçantë, që përmban të dhëna nga Policia e Kosovës, lidhur me numrin i vizitorëve të huaj sipas pikëkalimeve kufitare gjatë vitit 2017-2019.



## Kërkohet ndryshimi i Ligjit të Punës



PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim një delegacion të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime Kosovë (KKEIK). Përfaqësuesit e kësaj platforme gjithëpërfshirëse nga komuniteti i biznesit kanë shfaqur qëndrimet e

tyre në lidhje me vonesën në miratimin e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, duke potencuar vështirësitë me të cilat po përballen bizneset. Sipas tyre, përveç me pandeminë në aspektin shëndetësor, bizneset po përballen edhe me pandeminë ekonomike e cila ka goditur shumë

biznese duke i sjellë skaj ekzistencës. Ata, gjithashtu, kanë kërkuar edhe ndryshime në Ligjin e Punës, duke potencuar nivelin e ulët të pagës minimale, ndërsa është diskutuar edhe për barazinë gjinore në borde si dhe përkrahjen ndaj produkteve vendore.

## Hoti premton vazhdimin e mbështetjes për gastronomët dhe shitësit me pakicë

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka takuar të premten përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve dhe të Rrjetit të Shitësve me Pakicë, të cilëve ua ka premtuar vazhdimin e mbështetjes financiare me masa konkrete të qeverisë. Kryeministri Hoti në këtë takim shpalosi pakon e re të mbështetjes në vlerë prej 200

deri 220 milionë eurosh për tremujorin e parë të vitit 2021 ku, midis të tjerash, përfshihet edhe zbritja e TVSh-së nga 18 përqind në 8 përqind për këtë vit, masa këto të parapara me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve dhe ata të Shoqatës së Shitësve me Pakicë, kërkuan nga kryeministri Hoti rishikimin e

mundësisë për zgjatjen e orarit të punës si dhe ndryshime në mënyrën e shpërndarjes së pakos së re të ndihmës për bizneset për vitin 2021. Në këtë takim u theksua rëndësia e vazhimit të bashkëpunimit dhe koordinimit midis qeverisë dhe komunitetit të biznesit, me qëllim që pasojat e pandemisë Covid-19 të përballohen më lehtë.





# Autoriteti i Konkurrencës heton KEDS-in dhe KESCO-n, kërkohet përfshirja e Prokurorisë Speciale

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kryetari i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, Valon Prestreshi, ka mbajtur të premtën konferencë për media në të cilën ka njoftuar se ky institucion ka nisur procedurat hetimore ndaj Kompanisë Kosovare për Distribuim me Energji elektrike (KEDS) dhe Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji elektrike (KESCO) nën dyshimet se kanë shkelur Ligjin e Mbrojtjes së Konkurrencës. "Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka filluar procedurë hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS dhe KESCO, të cilat operojnë në tregun e energjisë elektrike. Hetimi ndaj këtyre ndërmarrjeve është autorizuar nga komisioni i AKK-së dhe

vjen si rezultat i një studimi të detajuar të tregut të energjisë në Kosovë. Gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka ngritur dyshime se ndërmarrjet KEDS dhe KESCO kanë bërë marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar dhe kanë abuzuar me pozitën dominuese në treg, duke rënë ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht nenet 4 dhe 11", ka thënë ai. Prestreshi ka theksuar se AKK-ja gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike, ka vërejtur se pala në procedurë, KEDS, ka abuzuar me pozitën dominuese, duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), duke kërkuar nga BRE-të, por edhe investitorët e tjerë,

që në rastet kur ata bëjnë investime në trafo-stacione, ato investime dhe prona ku gjendet trafo-stacioni të barten në pronësi të ndërmarrjes KEDS, duke vendosur kufizime në pajisje apo produkte që nevojiten për t'u kyçur në sistemin e shpërndarjes, duke kërkuar nga investitori që të gjitha pajisjet që nevojiten që instalohen të jenë të një marke të pranueshme për KEDS si dhe të kenë teste të tipit të duhur sipas procedurave të brendshme të KEDS-it. "Ekzistojnë dyshimet se KEDS-i në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ka vendosur çmimin joreal të blerjes apo shitjes, ose kushte të tjera të padrejta tregtare; kanë zbatuar kushte të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet e tjera duke i sjellë ato në një pozitë të

pafavorshme në raport me konkurrencën, dhe kanë vendosur çmime ose kushte të tjera që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjes jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre", është shprehur ai. Prestreshi ka shtuar se, po ashtu, gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë, AKK-ja gjithashtu ka vërejtur se palët në procedurë, KEDS dhe KESCO, kanë arritur marrëveshje të ndaluar ose kanë bërë praktikë të bashkërenduar duke shfrytëzuar objektin e njëjtë, duke shfrytëzuar ekspertët e njëjtë, duke mbajtur kontabilitet të përbashkët nga e njëjta zyrë dhe duke bërë shkëmbimin e informacioneve. "Ndërmarrjet KEDS dhe KESCO dyshohet se kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo

praktikë të bashkërenduar në atë mënyrë që: kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese; kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave. AKK-ja ka kërkuar një mori dokumentesh nga palët e lartcekura, të cilat kanë një afat prej 30 ditësh që dokumentet e kërkuara t'ia dorëzojnë AKK-së. AKK-ja do t'i njoftojë mediat dhe publikun e gjerë lidhur me çdo zhvillim të rëndësishëm rreth këtij rasti", është shprehur Prestreshi.



## Nënshkruhet Korniza e Bashkëpunimit të Qëndrueshëm Ekonomik 2021-2025

Prishtinë, 3 dhjetor (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti dhe koordinatoreja për Zhvillim e Agjencive të OKB-së në Kosovë, Ulrika Richardson, nënshkruan Kornizën e Bashkëpunimit të Qëndrueshëm Ekonomik 2021-2025, midis Republikës së

Kosovës dhe Agjencive të OKB-së në Kosovë. "Këtë bashkëpunim të mirë po e thellojmë duke u përqendruar në fushat prioritare, si: qeverisje të përgjegjshme, shërbime dhe politika shoqërore gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm

dhe gjithëpërfshirës, kohezioni social dhe barazia gjinore, fuqizimi dhe angazhimi i shoqërisë civile", ka theksuar kryeministri Hoti. Kryeministri Hoti, po ashtu, vlerësoi bashkëpunimin e mirë ndërmjet qeverisë dhe Agjencive të OKB-së në Kosovë në luftën kundër Covid-19.



## QKMF-ja në Skenderaj ndan hapësirë të veçantë për pacientët me Covid-19

SKENDERAJ, 4 DHJETOR (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Skenderaj (QKMF) tani është me hapësirë të veçantë për trajtimin e personave të infektuar me Covid-19. Kjo ndarje e hapësirës është bërë për arsye të mosrrezikimit të

pacientëve të tjerë të cilët marrin shërbime të tjera në QKMF.

Kryetari i komunës, Bekim Jashari, ka thënë se mantelbardhët e kësaj qendre po punojnë 24 orë me angazhim maksimal për t'u shërbyer qytetarëve të

komunës sonë. "Shtimi i kujdesit nga ana jonë për ta parandaluar infektimin e mundshëm me këtë virus është më së i nevojshëm, duke iu përmbytur rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike", ka thënë kryetari Jashari.



## Në institucionet shëndetësore në Mitrovicë shpërndahen posterë me mesazhe kundër dhunës në familje



MITROVICË, 4 DHJETOR (ER) - Në kuadër të zhvillimit të fushatës "16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore", mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje ka realizuar aktivitetin e radhës me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve. Me këtë rast,

drejtoresha e Shëndetësisë në Mitrovicë, Erseka Hasanaj-Barani dhe koordinatoreja e mekanizmit kundër dhunës në familje, Besa Veseli, kanë vizituar institucionet shëndetësore, ku në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në këtë qytet dhe në disa AMF kanë bërë shpërndarjen e

posterëve, ku janë të paraqitura përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësorë për raportimin e dhunës në familje. Ky aktivitet është financuar nga Organizata "UN Women" dhe posterët e përgatitur kanë qenë në katër gjuhë: gjuhën shqipe, turke, rome dhe serbe.

## Fillon asfaltimi në rrugën "Avdurrahim Shehu" në Kaçanik

KAÇANIK, 4 DHJETOR (ER) - Në një terren të ashpër, pas përgatitjes së rrugës me të gjitha kushtet e nevojshme, ka filluar asfaltimi në rrugën "Avdurrahim Shehu" në Kaçanik, një projekt madhor që është ndarë në dy faza. Nga afër asfaltimin e përcolli kryetari i komunës, Besim Ilazi, së bashku me bashkëpunëtorë, duke e konsideruar këtë projekt një të arritur të rëndësishme për infrastrukturën rrugore në Kaçanik, në një segment aq të rëndësishëm rrugor në këtë pjesë. Ilazi ka thënë se për shkak të terrenit të vështirë, paraprakisht janë realizuar shumë punime si vendosja e mureve mbrojtëse, rregullimi

dhe përshtatja e rrugës për asfaltim etj.

Vitin e kaluar ka përfunduar faza e parë e punimeve, ndërsa këtë vit nga fondi i ndarë nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe Komuna e Kaçanikut në këtë rrugë janë përfshirë zgjerimi, rregullimi i kanalizimit atmosferik dhe fekal, ujësjellësi, trotuari dhe muret mbrojtëse, ku përfshinë gjatësinë e rrugës 1 440 metra. Komuna e Kaçanikut është radhitur në mesin e top pesë komunave të Kosovës për performancën më të mirë komunale, ku edhe është shpërblyer me shumën afër 170 mijë euro. Ky projekt është bashkëfinancim i MAPL-së dhe Komunës së Kaçanikut.



## Vendoset gurthemeli për ndërtimin e shkollës së mesme në Gadime

LIPJAN, 4 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me drejtorin e shkollës Naser Kaqara dhe me bashkëpunëtorë të tjerë, kanë vendosur gurthemelimin për ndërtimin e objektit të ri të shkollës së mesme në Gadime të Epërme. Me këtë rast, kryetari Imri Ahmeti ka uruar banorët për këtë projekt jashtëzakonisht të rëndësishëm për ndërtimin e

një objekti të ri shkollor sipas standardeve më moderne, objekt ky që pritet të përfundojë dhe të përurohet në verën e vitit të ardhshëm. "Jam i lumtur që jam sot në Gadime për vendosjen e gurthemelit të këtij objekti i cili do t'i përmbyshë të gjitha kriteret e nevojshme për të funksionalizuar një shkollë. Do të mbetet obligim yni i përbashkët që në vazhdimësi t'i plotësojmë të gjitha kushtet që të arrijmë një edukim sa

më cilësor në mësimnxënie për gjeneratat që po vijnë", është shprehur Ahmeti. Ndërsa drejtorët e dy shkollave në Gadime në emër të nxënësve, mësimdhënësve dhe banorëve kanë falënderuar kryetarin Imri Ahmeti për gatishmërinë dhe vullnetin e treguar për ndërtimin e kësaj shkolle shumë të nevojshme. Ky projekt është investim i Komunës së Lipjanit dhe do të kushtojë 167 447.32 euro.



Reagim i KMDLNj-së

# Përshkallëzimi dhe degradimi i fjalorit dhe sjelljes, në shpërputhje me mandatin e deputetit dhe politikanit!

Në Kuvendin e Kosovës sot mund të dëgjoni çdo gjë, por më së paku ato për të cilat deputeti e ka fituar mandatin nga qytetari - votuesi. Më shumë se 20 vjet pas përfundimit të luftës, në vend se fjalori të përmirësohet sikur që është rasti me demokracitë e zhvilluara dhe të konsoliduara, në Kosovë kemi një degradim të skajshëm të fjalorit dhe të sjelljes e që është në kundërshtim, jo vetëm me mandatin e deputetit por edhe me një standard minimal të sjelljes dhe të komunikimit. Fitohet përshtypja që çdo përbërje e re e Kuvendit të Kosovës është më e dobët, profesionalisht, në radhë të parë se ato paraprake për faktin se partitë i riciklojnë të njëjtit deputetë, për mandate të tëra, kryesisht në saje të dëgjueshmërisë ndaj subjektit dhe liderit. Deputetët e Kuvendit të Kosovës e harrojnë faktin se mandatin nuk e kanë nga partia por nga populli dhe vetëm atij i përgjigjen. Vetëm qytetari - votuesi ka të drejtë t'ua marrë mandatin në zgjedhjet e radhës dhe është



koha e fundit që votuesi të jetë shumë i vëmendshëm se kujt ia jep votën. Nuk ka fuqi në botë që ia ndalon deputetit mandatin e fituar nga populli përmes kërcënimit se nuk e lënë të hyjë në sallën e Kuvendit pavarësisht nëse është deputet apo politikan përveç nëse ka pengesa ligjore. Besoj se vetëm në Kuvendin e Kosovës ndodh që deputeti vjen dhe nënshkruhet sa për ta dëshmuar praninë dhe për mëditje dhe, pas pesë minutave largohet nga Kuvendi që është shkalla më e ulët e përgjegjësisë dhe mungesë e një morali elementar. Ky më nuk është rast i

izoluar, por është shndërruar në dukuri dhe mënyrë të sjelljes e që përfundon me një kërcënim të kryesueses/it të seancës se do t'i heqë mëditjen në kohën që për këtë nuk ka kompetencë e as mundësi. Është krejtësisht e pamoralshme mungesa e deputetëve në seancë për shkak të së cilës thuaja shumica e seancave përfundojnë në mungesë të kuoromit prandaj nuk votohen as ligjet dhe as rezolutat për të cilat edhe thirren seancat e jashtëzakonshme. Është e papërgjegjshme dhe në kundërshtim me moralin elementar të një të zgjedhuri të popullit të largohesh nga seanca

pas 10 minutave pasi jeni nënshkruar dhe keni krijuar mbulesë për mëditje kur, në anën tjetër një pjesë e deputetëve të përgjegjshëm, administrata e Kuvendit dhe të tjerët që janë pjesë e Kuvendit, edhe në kushte të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 qëndrojnë në seancë deri në 12 orë, duke e tejkaluar orarin e rregullt të punës. Është krijuar madje një standard që një pjesë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pasi janë nënshkruar në listë, e lëshojnë seancën dhe diskutimet i vazhdojnë në kafiteri dhe restorante përreth Kuvendit të Kosovës. E tëra kjo ndodhë për faktin se për shkak të pandemisë, më nuk ka monitorim efektiv të punës së Kuvendit, as nga vendorët dhe as nga ndërkombëtarët dhe këtë situatë deputetët e Kuvendit të Kosovës e keqpërdorin maksimalisht. Në këtë situatë, kur Kuvendi i Kosovës nuk është në gjendje ta përbushë mandatin, miratimi i ligjeve dhe mbikëqyrja e punës së Qeverisë së Kosovës dhe kur shumica e seancave përmbillen për shkak të mungesës së


kuoromit, KMDLNj, përveç shqetësimit të bazuar, e shtron edhe një pyetje krejtësisht logjike; a ka kuptim që Kuvendi, në këtë përbërje dhe me këtë punë që nuk prodhon asgjë përveç sharjeve, fyerjeve, etiketimeve, ndërhyrje në jetën private dhe familjare, konfrontimeve verbale dhe fizike (që nuk ndërlihen me mandatin e deputetit), të vazhdojë me mospunën dhe papërgjegjësinë e skajshme, siç kanë vepruar deri më tani?! KMDLNj mendon se duhet të gjendet një mënyrë që të sigurohet prania e përhershme e monitoruesve në Kuvend në mënyrë që të bëhet një presion pozitiv te deputetët e papërgjegjshëm sikur që duhet të bëhen ndryshime në Rregulloren e Punës së Kuvendit me të cilën do të sanksionoheshin deputetët që nuk sillen në përputhje me mandatin që e kanë dhe, sidomos do të duhej të pamundësohej mundësia që deputetët azilantë (prej 5-30 minuta të qëndrimit në seancë) të përfitojnë, qoftë përmes mëditjeve apo formave të tjera.

## Doli nga shtypi libri “Besimi islam, shtyllat dhe veçoritë” i myftiut Naim ef. Tërnavë

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ka dalë nga shtypi libri “Besimi islam, shtyllat dhe veçoritë” i myftiut të Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Që në fillim të librit autori thekson se për të shkruar për shkencën apolegjetikës islame duhet një përkushtim dhe vendosmëri e madhe, veçanërisht kur kihet parasysh se gati i tërë brumi i kësaj shkence ka të bëjë me Kuranin dhe sunetin. Ky libër fillon me kushtin e parë të besimit në Zotin xh. sh. dhe hap shtegun e njohurive të tjera për fenë në përgjithësi. Pra, edhe ky libër shtjellon parimet kryesore të kushteve të imanit (besimit) dhe merret me problematikat thelbësore gjithëpërfshirëse të këtyre kushteve të besimit. I tërë materiali i këtij libri ka vetëm këtë qëllim: besimin dhe adhurimin e drejtë në Krijuesin e vetëm të këtij universi, me gjithë çfarë ka në të dhe përtej tij. Gjatë leximit të këtij libri lexuesi do të shohë se Allahu xh. sh. në shumë vende në Kuranin e urdhëron që ta besojmë Allahun

një dhe të largohemi nga besimet e devijuara, besimet politeiste në shumë zota. Pra, Allahu xh.sh. vazhdimisht na e bën me dije se ai është një dhe se nuk ka tjetër si ai. Kurani na mëson edhe mënyrën e besimit në Allahun xh. sh., adhurimin e tij, përmes veçorive që ia ka dhuruar njeriut për dallim nga krijesat e tjera. I Lartmadhërishtmi na bën me dije se çdo gjë në këtë gjithësi flet se Allahu xh.sh. është një dhe krijuesi i çdo gjëje. Gjithë këto argumente në këtë gjithësi, si në qiej e tokë, flasin për Madhërinë e Tij. Allahu xh. sh. thotë: “Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kurani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është Dëshmitar për çdo gjë?!” (Fussilet: 53). Autori më pas shtjellon kushtet e tjera të besimit si: besimi në engjëj, besimi në librat e shpallur prej Allahut xh. Sh., besimi në të dërguarit e Allahut xh.sh., besimi në Ditën e Fundit, në Ditën e

Kiametit, besimi në Kadanë dhe Kaderin. Besimi në emrat dhe cilësitë e Zotit është çështje tjetër me të cilën merret ky libër. Është një kapitull i tërë ku janë shpjeguar kriteret që kanë të bëjnë me kuptimin dhe interpretimin fetar të emrave dhe cilësive të Allahut, bashkë me shpjegimin veç e veç për emrat. Ky libër është punuar i pandikuar nga mendimet e ndryshme të dijetarëve dhe fraksioneve të ndryshme. Ky libër është punuar në frymën e drejtimit të Ehli Sunetit vel Xhematit, më saktësisht të shkollës apo doktrinës akaidologjike, dhe është bazuar në mendimet e Imam Maturidiut dhe të dy bashkëkohësve të tij, Eshariut dhe Tahaviut, të cilët, pra Maturidiu dhe Eshariu, ndonëse jetuan pothuajse në të njëjtën kohë, kurrë nuk u takuan dhe as që ditën për mësimet e njëri-tjetrit. Libri ka dy vëllime me 14 kapituj. Librin mund ta gjeni në të gjitha zyrtar e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës gjithandej komunave si dhe në Librarinë “Dituria islame” në ndërtesën e Kryesisë së BIRK-ut.



## Mici, futbollisti më i vlefshëm në Superligë

**PRISHTINË, 4 DHJETOR** - Mbrojtësi i majtë i Prishtinës, Gledi Mici, është lojtari më i shtrenjtë në Superligën e Kosovës në futboll, pasi vlera totale e tij është 475 mijë euro. Superliga që disa edicione është bërë shumë interesante

dhe përballjet me ekipet po janë shumë të forta. Krejt kjo vjen si shkak i investimeve të mëdha të ekipeve në lojtarë. Ndërkaq këtë vit, apo saktësisht në edicionin 2020/21, klubet e Kosovës kanë investuar para të mëdha

duke transferuar super-lojtarë të cilët kanë vlerë të madhe. Në këtë edicion, sipas uebfaqes "transfermarkt.com", lojtari më i shtrenjtë në Superligë është Gledi Mici i Prishtinës, i cili ka vlerë 475 mijë euro. Pas tij vjen Marko

Simonovski i Ferronikelit, që ka vlerë 450 mijë euro. Në vendin e tretë është Vladica Brdarovski i Dritës me vlerë 400 mijë euro. Në vendin e katërt dhe të pestë janë dy lojtarët e Prishtinës, Ahmed Raddaoui dhe Enis Gavazaj, që



kanë vlerën e njëjtë prej 350 mijë eurosh.

## Mezani: Në Kosovë kam pasur sulme të njëpasnjëshme

**TIRANË, 4 DHJETOR** - U bë një javë që iku nga Gjilani, por vetëm tani zbulon arsyet e vërteta të këtij vendimi. Gentjan Mezani rrëfen për "Panorama Sport" se në Kosovë është ndier i sulmuar për dy vjet me radhë. Dorëheqjen e kishte menduar më parë, ndërsa e cilëson një aventurë pozitive dhe vlerëson marrëdhënien e veçantë që ka pasur me presidentin. Nuk kishte si të mos fliste edhe për Flamurtarin, për të cilin shpreson që ta shijojë fitoren e parë në ndeshjen me Tomorin.

*Pse u largua Mezani nga Gjilani?*

**Mezani:** E kisha menduar që më parë. Pas një problemi familjar që kalova, nuk e dija sa do të mungoja dhe mendova që klubi duhet të bënte një zgjidhje tjetër. Gjithsesi, presidenti nuk e pranoi. Me rikthimin tim, disa gjëra nuk shkuan ashtu siç duhet dhe mendova që të ikja për të mos humbur investimin. Kjo ishte një çështje morale imja, pasi mbështetja dhe besimi i presidentit nuk më ka munguar kurrë.

*Mendoni se ka pasur paragjykimet ndaj jush në Kosovë?*

**Mezani:** Nuk mund të them ka pasur apo jo paragjykimet në ambientin që më rrethonte, pasi ne kemi pasur rezultate dhe arritëm edhe objektivin që kishim



vendosur. Por, një gjë më ka bërë shumë përshtypje dhe kjo nuk ishte vetëm sivjet, por ka qenë edhe vjet. Kanë qenë sulme të njëpasnjëshme kundrejt meje dhe lojtarëve nëpër studiot televizive. Nuk e di nga u lindi ajo urrejtje, sepse e shfaqnin shumë.

*Si e vlerësoni përvojën në Kosovë?*

**Mezani:** Për mua ka qenë një

përvojë shumë e bukur dhe ndihem mirë që bëra shumë miq të rinj atje, përpos aspektit profesional.

*Po përflitet se mund ta merrni drejtësinë e një skuadre në Kategorinë Superiore. Keni pasur kontakte me Laçin dhe Apoloninë?*

**Mezani:** Asnjë skuadër nuk më ka kontaktuar.

## Bahreini, për herë të dytë stacioni i radhës në Formula 1

**MANAMA, 4 DHJETOR** - Emocionet në Kampionatin Botëror të Formula 1 do të vazhdojnë me garën e 16-të të sezonit që do të zhvillohet në Bahrein. Sipas Anadolu Agency (AA), gara e 16-të e kalendarit për vitin 2020 që është revizionuar për shkak të pandemisë së koronavirusit të ri (COVID-19) do të zhvillohet në pjesën prej 3 543 metrash të pistës së garës paraprake, Pista Ndërkombëtare e Bahreinit në shkretëtirën Sakhir. Kujtojmë se në klasifikimin e ekipeve, Mercedes dhe në klasifikimin e pilotëve Lewis Hamiltoni kanë arritur ta fitojnë kampionatin. Për arsye se Hamiltoni i Mercedesit është prekur me COVID-19, në vend të tij do të garojë britaniku



22-vjeçar, George Russell. Xhirot për renditjen e garës me 87 xhiro do të fillojnë të shtunën në orën 18:00, ndërsa gara të dielën më 6 dhjetor në orën 18:10. Para Çmimit të Madh të Sakhir, piloti i

Mercedesit, Hamilton, ka 11 fitore, shoku i tij i ekipit Valtteri Bottas 2, Max Verstappen (Red Bull-Honda) dhe Pierre Gasly (AlphaTauri-Honda) nga një fitore.

### SHKURT

#### Tevezi, Maradonës: Do ta jap zemrën që të të bëj të lumtur

Sulmuesi Carlos Tevez ka shpërndarë një mesazh në "Instagram" për ta nderuar figurën madhështore të Diego Armando Maradonës. Ai ka veshur fanellën me numër 10 të kësaj skuadre, të cilën e ka ngritur në piedestal "Pibe de Oro": "Çdo dedikim do ta bëj për ty, por do të jetë shumë i vogël para madhësisë tënde. Në foto që janë shfaqur deri tani, nuk përcillet largimi yt: tregoj qiellin, por vështrimi është nga poshtë. Kudo që të jesh, e di që më jep forcë për të vazhduar. Nuk di nëse do të jem në lartësinë e detyrës, por për një gjë jam i sigurt: do të jap zemrën time që të të bëj të lumtur. Më mungon, mik!".

#### Barça i ofron kontratë të re Demebeles

Barcelona do të përballë të shtunën në mbledhje me Cadizin. Një sfidë që duhet fituar me çdo kusht për ta vazhduar ngjitjen drejt kreut. Ndërkohë, drejtuesit e klubit po mendojnë t'i dhurojnë rinovimin Ousmane Demebeles. 23-vjeçari francez ka shënuar 4 gola këtë sezon, nga të cilët tre në Ligën e Kampionëve. Kontrata e tij përfundon në verën e vitit 2022.

#### Nice e shkarkon Vieiran

Skuadra e Nicës e k shkarkuar Patrick Vieira nga detyra e trajnerit. Skuadra franceze ka vendosur t'i ndajë rrugët me trajnerin francez, i cili ishte emëruar në këtë pozitë në vitin 2018. Nice këtë sezon nuk e ka nisur në mënyrën më të mirë, ku pas 11 xhirosh renditet në vendin e 11, me 17 pikë.

#### Chelsea do ta largojë Kepan

Portieri Kepa Arrizabalaga do të largohet përfundimisht nga skuadra e Chelseat. Bëhet me dije se drejtuesit e klubit kanë vendosur ta nxjerrin në shitje spanjollin gjatë afatit kalimtar të janarit, pasi nuk bën pjesë në planet e trajnerit Frank Lampard. Portieri 26-vjeçar këtë edicion ka vetëm tri paraqitje në të gjitha garat dhe tashmë e ka humbur vendin e titullarit nga Edouard Mendy. Kepa në vitin 2018 iu bashkua Chelseat me bujë të madhe, por asnjëherë nuk arriti ta arsyetojë çmimin e tij. Londinezët patën paguar 80 milionë euro, shumë kjo rekorde për ta transferuar nga Bilbao. Kepa ka kontratë me Chelsean deri në vitin 2025.

#### Joshua: Jam më pranë duelit me Usyk sesa me Fury

Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë (IBF, WBA, WBO), ka vënë në dilemë dy sfidat që ai ka planifikuar vitin tjetër me Tyson Fury. Joshua ka thënë se është më pranë zhvillimit të një dueli me ukrainasin Oleksandr Usyk sesa me patronin e tij Fury, që mban titullin e kategorisë WBC. "Unë nuk e di nëse Fury do të duelojë më Wilder apo jo. Nuk e di nëse ai do të duelojë më Kabayel apo jo. Ai deklaroi se do të përballë me mua, por nuk e ka firmosur marrëveshjen dhe ne nuk po duelojmë", ka thënë Joshua. "Unë nuk e di se çfarë do të ndodhë vitin tjetër, por nëse do të vija bast të gjitha paratë e mia, do të thosha se do të përballë me Usyk. Ai është pjesë e kompanisë Matchroom si unë, i pamposhtur, kampion bote dhe i mandatuar. Kur ai thotë se do të përballë me dikë, ai e realizon këtë gjë", ka shtuar Joshua, i cili ka 23 fitore e 1 humbje në karrierën e tij. Joshua do të mbrojë më 12 dhjetor titujt kampionë bote në një duel ndaj Kubrat Pulev, në Londër.



**D P A**  
Departamenti për punë administrative

Mitrovicë / Nr.

Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MF-NR.07/2017, me datën 04.12.2020 mori vendim për të shpallë:

**K O N K U R S**

(Per plotësimin e vendeve te lira te punës, punë provuese 6 muaj me mundësi vazhdimi)

1. Një (1) Zyrtar/e për Shërbime me Konsumatorë
2. Gjashtë (6) Lexues të Ujëmatësve
4. Një (1) Rojtar

**1. Një(1) - Zyrtar/e për Shërbime me Konsumatorë**

**Pershkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- përkujdeset dhe është përgjegjëse te mban kontakte te vazhdueshme me Konsumatorët me kontrata
- pranon shkresat dhe dokumentet e ndryshme nga konsumatorët lidhur me kontratat dhe i dërgon tek personi përgjegjës ne KRUM,
- merr pjesë ne mbledhjet e organizuara nga shërbimi me Konsumator dhe raporton tek mbikqyresi i tij për ecurit dhe zhvillimet e reja,
- dërgon shkresat, kërkesat dhe raportet si dhe dokumentet e tjera nga KRUM ne Institucionet tjera,
- ne bashkëpunim me departamentet e Kompanisë bene pergaditjen e dokumentacionit te nevojshëm per Permbarim ,
- përcjell Kontratat e Konsumatorëve a po ju përmbahen pagesave te borxhit,
- njofton konsumatorët ne menyre elektronike ose nepermejt telefonit për mos respektimin e kontratave,
- ne bashkëpunim me Zyrën Ligjore i jep propozimet për dërgim ne përmbaram te konsumatorëve qe s'ju përmbahen kontratave,
- Kryen te gjitha punët qe i përkasin këtij vendi të punës.

Pregaditja shkollore: Shkolla e Mesme

**2. Gjashtë (6) Lexues të Ujëmatësve - Pershkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- bënë leximin e ujëmatësit dhe është përgjegjës për rregullat e dhënjes së faturave, zbaton drejt tarifata,
- është i obliguar që me specifikacion të rregullt, gjithashtu duhet të raportoj për gjendjen e lexuar dhe për faturat e pa realizuara,
- gjatë leximit të ujëmatësit është i obliguar që për çdo ndryshim me ujëmatës si dhe ndonji prishje në të, që menjëherë ta lajmëroj udhëheqësin kompetent,
- gjatë kontrollimit të terrenit është i obliguar që të kontrolloj dhe lajmëroj kyqjet ilegale (të egra) të mshehura,
- i duhet të jetë edhe komisioni gjatë kontrollit për vërtetimin të gjendjes faktike për reklamim,
- bënë punën e vet, përgjigjet para organit përgjegjës (udhëheqësit) për kryerjen e detyrave të punës,
- kryen edhe detyra dhe punë tjera sipas urdhërit të Udhëheqësit paraprak.

Pregaditja shkollore: Shkolla e Mesme.

**3. Një (1) Rojtar - Pershkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Bënë ruajtjen e objektit dhe hapësirave përreth,
- Ruan automjetet që të mos vijë deri te thyerja, dëmtimi dhe vjedhja e tyre,
- Mban evidencën e hyrjes-daljes të automjeteve dhe mjeteve tjera nga lokalet e kompanisë,
- Të ketë kujdes në evitimin e shkaqeve të zjarrit si dhe në shuarjen e tij nëse vjen gjerë te zjarri,
- Mban evidencën e hyrjeve dhe daljeve të personelit të kompanis si dhe palëve të tjera,
- Punët dhe detyrat e punës i kryen në katër ndrrime,
- Në rast vizites nga ana e udhëheqësit i raporton mbi gjërat e të vërejtura gjatë punës së tij,
- Kryen edhe punë tjera në këtë vend pune sipas urdhërit të udhëheqësit të kompanisë.

Pregaditja Shkollore : Shkolla filllore,

Paga mujore :sipas Rregullores mbi ndarjen e te ardhurave.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, referencat dhe certifikatat- të lindjes, të mos jetë nën hetime dhe i dënuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njëjti nuk u kthehet aplikantëve. Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen Epoka e re. Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Zyra Nr.6  
Drejtoria e KRUM.  
Rr. Bislim Bajgora pn.  
Mitrovicë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO



OPSTINA STRPCE  
KOMUNA SHTRËPCË  
MUNICIPALITY OF STRPCE

**Komuna Shtërpçë**

**Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Bazuar në Ligjin e Punës nr.03/L-212 neni 8; Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 35 paragrafi 1, 4 dhe 5; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, neni 5 pika c; Udhëzimi Administrativ (MPMS) 07/2017; Udhëzimin Administrativ 10/2018 (MASHT) Normativ për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

**K O N K U R S**

SHFMU. "Anton Santori" Bitijë

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës/e klase

Koeficient: A-421/1

Numri i referncës: 08-111/01-13342/20

Pershkrimi i vendit të punës:

**DETYRAT KRYESORE**

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies. Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me Kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi.

Të ketë njohuri për një repertuar të gjërë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t'i aplikoj ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë. Të shfrytëzoj në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion. Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënësin dhe sjelljen e secilit nxënësi.

Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare. Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj nxënësve. Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënësi dhe të jetë në gjendje t'i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës. Të zgjoj te nxënësit kureshtjen për të nxënë dhe t'i inkurajoj ata të nxënë në mënyrë të pavarur.

Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/ kujdestarë të fëmijës.

Të ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës.

Të mbikqyrë dhe të udhëzoj nxënësit në procesin mësimor.

Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës.

Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.

Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënësi dhe kryej me përgjegjësi ekskursionet me nxënësi brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës.

Të tregoj respekt, sjellje kolegjiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon.

Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.

I punësuar është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar në rregullorën e brendshme të shkollës.

Kushtet e konkursit:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas UA. 10/2018 (MASHT):

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata

Kohëzgjatja e kontratës fillon prej datës së fillimit të punës deri më 31.08.2021

Fletëaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuara të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpçës, zyra nr. 28

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar (tabela e shpalljeve, webfaqen e komunës, gazetë ditore), duke filluar nga data 04.12.2020 deri më 18.12.2020

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Dua Shoes” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811299587 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dua Shoes” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811299587, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Dua Shoes” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811299587 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “BARDHA” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810867004 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BARDHA” DO.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810867004, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “BARDHA” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810867004 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Vicianum Hotel” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810192146 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Vicianum Hotel” DO.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810192146, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Vicianum Hotel” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810192146 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Gold Stone” L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përpunimin, thërrmimin dhe sperimin e gurit gëlqeror në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.12.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Bjeshka” i cili ndodhet në anën a djathtë të rrugës Malishevë-Rahovec, komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania “Gold Stone” L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përpunimin, thërrmimin dhe sperimin e gurit gëlqeror në Rahovec.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WETvcTlOMSS1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, Nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të punës Nr. 03/L-2012, Nenit 17 paragrafi 1 të ligjit për Teatro Nr.04/L-106 dhe udhëzimit administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik Komuna Mitrovica e Jugut shpall:

**KONKURS**

Për plotësimin e stafit në Teatrin e Qytetit „Muharrem Qena”

Institucioni: DKRS/ Teatri „Muharrem Qena” Mitrovicë

- 1. Titulli i pozitës:** Organizator
- Nr i pozitave : 1 (Një)
  - Grada /koeficienti 7.00
  - I përgjigjet: Drejtorit të përgjithshëm
  - Orari i punës : 1 plotë 40 orë në javë

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Të organizoj mbajtjen e provave të shfaqjeve dhe sipas kërkesave angazhohet në shfaqje,
- Të hulumtoj dhe lexoj materiale apo të ndërmarr aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të aktorëve,
- Të bashkëpunoj me të tjeret dhe regjisorin,
- Të inqizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit,
- Të performoj në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevoja që paraqitet,
- Të bashkëpunoj drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjeve,
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së drejtorit të Teatrit në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tij i përgjigjet regjisorit, udhëheqsit artistik dhe Drejtorit të Teatrit.

**Kualifikimi dhe shkathtësit e kërkuesit;**

- Pregaditja Universitare ( Diploma e Fakultetit)
- Dy vite përvojë pune profesionale
- Njohja e gjuhës angleze përparësi
- Njohja e punës praktike administrative
- Aftësi të mira menaxheriale
- Aftësi të mira në komunikim verbal dhe të shkruar.
- Të ket njohuri të mira për funksionimin e Teatrit si institucion dhe art.
- Të jet i/e motivuar ,profesional dhe qasje pozitive.
- Njohuri e punës me kompjuter,word,excel etj.
- Të jet fleksibil dhe krativ duke marrë parasysh edhe kriteret e veshitruara te punes.

- 2. Titulli i pozitës:** Pastruese
- Numri i pozitave : 1 (një)
  - Grada/koeficienti 5.00
  - I përgjigjet ; Drejtorit të Përgjithshëm

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Kujdeset për nivelin e pastërtisë në objektin e Teatrit
- Bënë pastrimin e skenes ,sallës se Teatrit,dyshemeve,dyerëve ,dritareve ,mureve, nujeve sanitare,koridoreve rregullisht para shfaqjeve ,programeve te ndryshme dhe ngjarjeve tjer anë teater.
- Njofton te gjitha dëmet eventuale që ndodhin pas shfaqjeve
- Kujdeset per ruajtjen e inventarit ,
- Kryen edhe detyra tjera në bazë të udhëzimeve nga Drejtori i Teatrit.

**Kualifikimi dhe shkathtësit e kerkuara;**

- Diploma e shkolles se mesme
- Njohja e punës praktike me pastrimin e hapsirave publike

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Të gjithë të pranuarit përmes Konkursit publik, marrin kontrata te përhershme pas periudhës provuese 6 mujore , sipas suksesit dhe angazhimit të treguar të paraparë me Rregulloret e sipërcekura.

**Dokumentacioni i kërkuesit:** • Diploma (Kopja e noterizuar) • fotokopja e Letërnjoftimit , ekstrakti i lindjes , rekomandime apo certifikata për pozitën në të cilën aplikoni nëse keni, dëshmit mbi përvojën e punës , certifikatën që nuk jeni nën hetime.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe të bashkëngjiten këto dokumente: Diploma mbi kualifikimin, fotokopja e letërnjoftimit; ekstrakti i lindjes, dëshmi mbi përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime dhe certifikata që dëshmojnë njohuri nga fusha përkatëse. Dokumentet duhet të jenë në një rënë prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028 – 532 104 dhe 028 515 559.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

**Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit**



Mitrovicë 01.12.2020



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Na osnovu člana 8 stavovi 1 i 2, člana 10 stav 2 podstav 2.1 Zakona o Radu Br. 03/L-2012, člana 17 stav 1 Zakona o Pozorištu Br.04/L-106 i Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br.07/2017 o regulisanju procedura konkursa u Javnom Sektoru, Opština Južna Mitrovica objavljuje:

**KONKURS**

Za popunjavanje osoblje Gradskog Pozorišta „Muharrem Qena”

Institucija: UKOS/ Pozorište „Muharrem Qena” Mitrovica

- 1. Naziv pozicije:** Organizator
- Br. pozicija : 1 (jedna)
  - Stepen /koeficijentat 7.00
  - Odgovara: Generalnom direktoru
  - Radno vreme: Puno, 40 časova nedeljno

**Zadaci i odgovornosti:**

- Da organizuje probe predstava i prema zahtevima se uključuje u predstave,
- Da istraži i čita materijale ili preduzma fizičke i intelektualne aktivnosti koje pomažu u pripremi uloge glumaca ,
- Da saraduje sa ostalima i režiserom,
- Da snima glas zavisno od potreba produkcije,
- Da nastupa u studiju ili na drugom mestu u zavisnosti od predstavjenih potreba,
- Da saraduje direktno sa režiserom predstava,
- Izvršava i ostale zadatke na zahtev direktora Pozorišta u skladu sa prirodom posla i njegovim pripremana;
- Za svoj rad odgovara režiseru, umetničkom rukovodiocu i Direktoru Pozorišta.

**Potrebna kvalifikacija i sposobnosti;**

- Univerzitetska sprema ( Diploma Fakulteta)
- Dve godine stručnog radnog iskustva
- Poznavanje engleskog jezika je prednost
- Poznavanje praktičnog administrativnog rada
- Dobre menadžerske sposobnosti
- Dobra sposobnost pisane i usmene komunikacije.
- Da ima dobro znanje o funkcionisanju Pozorišta kao institucije i umetnosti.
- Da bude motivisan/a, stručan/a i da ima pozitivan pristup.
- Poznavanje rada na kompjuteru,word,excel itd.
- Da bude fleksibilan i kreativan uzimajući u obzir teške kriterijume rada.

- 2. Naziv pozicije:** Čistač
- Broj pozicija: 1 (jedna)
  - Stepen/koeficijentat: 5.00
  - Odgovara: Generalnom Direktor

**Zadaci i odgovornosti:**

- Stara se o nivou čistoće u objektu Pozorišta
- Vrši čišćenje scene, sale Pozorišta, podova, vrata, prozora, sanitarnih čvorova, zidova, hodnika pre predstava, raznih programa i događaju u pozorištu.
- Najavljuje sve moguće štete nastale nakon predstava
- Stara se o čuvanju inventara,
- Izvršava i druge zadatke na osnovu uputstva Direktora Pozorišta.

**Potrebna kvalifikacija i sposobnosti;**

- Diploma srednje škole
- Poznavanje praktičnog rada u čišćenju javnih površina

**Uslovi učešća na konkursu:** Pravo na prijavu imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost da deluju i koji imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za izvršenje zadataka.

**Trajanje imenovanja:** Svi primljeni preko Javnog konkursa, dobijaju trajne ugovore nakon probnog rada od 6 meseci, u skladu sa uspehom i zalaganjem prikazanim gore navedenim propisima.

**Zahtevana dokumentacija:** • Diploma (Overena kopija) • fotokopija Lične karte, ekstrakti i lindjes , izvod iz matične knjige rođenih, preporuke za određene gore navedene oblasti za radno mesto na kome se prijavljujete, dokazi o radnom iskustvu, potvrda da niste pod istragom.

**Podnošenje zahteva:** Prijave se primaju i i podnose u kancelariji br. 10 u Opštini Južna Mitrovica. U prijavi treba jasno da se navede naziv radnog mesta i referentni broj i dodaju sledeći dokumenti: diplome o kvalifikaciji, fotokopija lične karte; izvod iz matične knjige rođenih; dokaz o radnom iskustvu; uverenje da nije pod istragom i certifikati koji pokazuju znanje iz odgovarajuće oblasti.

Dokumenti moraju biti na jednom od zvaničnih jezika opštine. Možete uspostaviti telefonske kontakte na 028 - 532 104 i 028 515 559.

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

**Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja**



Mitrovica 01.12.2020

## NIOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **AUTOSHKOLLA "AB-EKS" SH.P.K** me seli në **Prizren**, ka marrë vendim të shuajë biznesin më numër të regjistrimit **810024282** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvimin. Njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obaveštavamo se svi klienti da Tvrtka **AUTOSHKOLLA "AB-EKS" SH.P.K LLC** u **Prizren** doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: **810024282** i ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obaveštavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **AUTOSHKOLLA "AB-EKS" SH.P.K, LLC**. In **Prizren** has come to the decision to quit its business with registry: **810024282**. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores –Mi nistarstvo Inostranih Poslova i Dijaspora –  
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

04.12.2020

## Njoftim për Anulimin e Konkursit

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores njofton të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e shpallur më datën: 15.07.2020, për pozitën: Nepunes te Misionit Konsullor, për arsye objektive bën anulimin e konkursit. Konkursi I ardhshem do të rishpallet posa të krijohen kushtet e nevojshme.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

## Obaveštenje o poništenju konkursa

Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspora obaveštava sve kandidate koji su se prijavili na raspisanom konkursu objavljen 15.07.2020 godine, za poziciju: Službenici Konzularne Misije, da zbog objektivnih razloga pouništava konkurs za navedenu poziciju. Sledeći konkurs biće ponovo raspisan čim se stvore potrebni uslovi.

Hvala vam na razumevanju!

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ Artan Ajazaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Leke Dugagjini " Prizren.
- ▶ Selman Nerjovaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Mustafa Baser shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Doruntina Sadiku shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shaban Idrizi" Mitrovicë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

*Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj*

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitetit lirik

*Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a enunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletarias poesías de oportunismos líricos*

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesit, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

*La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida*

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*  
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6.99 €

KAFE ME NËNËN  
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFE ME NËNËN poeziCAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor

reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

*Lakorja e fatit* çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarëve tregimtarë, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4.99 €



Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT  
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

